

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti dhënies në përdorim: Bashkia Elbasan, adresa: Rr. “Qemal Stafa”, nr.tel/fax:(+355)54 400152, e-mail : bashkiaelbasan@elbasani.gov.al.

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja e fondit pyjor prej 78 ha:

Loti parë: Për sasinë totale prej 33 (tridhjetë e tre) ha në n/ngastren pyjore 14a, 15a, 16a , ekonomia pyjore “Labinot”.

Loti dytë: Për sasinë totale prej 45 (dyzet e pesë) ha në n/ngastrat pyjore nr.59/a, 65/b, 66/b dhe 75/e ekonomia pyjore “Labinot”.

3. Qëllimi i dhënies në përdorim:

Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.

4. Afati i dhënies në përdorim:

Loti parë është 10 (dhjetë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Loti dytë është 10 (dhjetë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e përdorimit:

Loti parë: 5,808,000 (pesëmilion e tetëqind e tetë mijë leke) Lekë/vit, pa T.V.SH.

Loti dytë:7,920,000 (shtatëmilion e nëntëqind e njëzet mijë leke) Lekë/vit, pa T.V.SH.

6. Vendi i Zhvillimit të Konkurimit: Konkurimi për marrjen në përdorim do të kryhet në ambjentet e zyrave të Agjencisë së Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit pranë godinës së Bashkisë Elbasan. Dokumentat standard të konkurimit tërhiqen në adresën e sipërcituar.

7. Vleresimi i ofertave konkurrese do të bëhet me pikë si vijon:

- projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
- planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
- masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar, për secilin lot më vehte, në dokumentet standarde të konkurimit.
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- d) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.
- e) vërtetim nga prokuroria, gjykata, Drejtoria Rajonale Tatimore, Taksat Vendore.
- f) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes.
- g) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV_në profesionale të tregohet provoja në fushën e veprimtarisë.

9. Dokumentacioni i nevojshëm:

- a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;

- c. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- d. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- e. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes;
- f. Nivelin e punësimit në veprimtari;
- g. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- h. Adresën e subjektit, telefon, e-mail dhe faks;

10. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie përdorim”, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues.

Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

Data e zhvillimit të konkurrimit:

Loti parë: datë 19.03.2024, ora 10:00,

Loti dytë: datë 19.03.2024, ora 11:00,

Në ambientet e Agjencisë së Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit, pranë godinës së bashkisë Elbasan Rruga “Qemal Stafa”, Tel.00355 545 3416.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 19.03.2024, ora 10.00.